



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 27 Prot

Rrëshen më, 05.01.2026

V E N D I M

Nr. 109 datë 29.12.2025

P Ë R

**“MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027 –
2029 DHE BUXHETIT VJETOR 2027”, BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 68/2017, pika 3, neni 48, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 7, datë 25.02.2022, "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" i ndryshuar, relacionin nr. 6343 prot, datë 23.12.2025, së bashku me projekt-vendimin dhe tabelën, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, shqyrtimin e miratimit në mbledhjen e datës 29.12.2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, për t'a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027, së bashku me relacionin nr. 6343 prot, datë 23.12.2025 dhe tabelën bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë; (GMS dhe të gjitha drejtoritë e agjensitë e bashkisë)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

Nr. 6343/Prot.

1

Rrëshen, më 23 12 .2025

P/V E N D I M

Nr. 110 datë 23/12.2025

PËR

**“MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029”
DHE TË BUXHETIT VITI 2027.**

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, në ligjin Nr.68/2017 dt.27.04.2017 ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’, Udhëzimin nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm “ i ndryshuar këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari I bashkisë:

V E N D O S I :

I-Të miratojë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029, dhe të buxhetit 2027.

II- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen GMS dhe të gjitha Drejtoritë dhe Agjensitë e Bashkisë

III-Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ


Aleksandër PICAKU

Paraqitën projektin

Dr/zhvill ek dhe tatim taksat:
Përgj.sek.juridik & prokurimeve

V.Gjoka
M.Topollaj

KRYETARI
Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al

KALENDARI I PROGRAMIT BUXHETORE AFATMESEM 2027-2029 DHE I BUXHETIT VJETOR

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI/PERSONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Dhjetor	Brenda muajit dhjetor	Kryetari I NJQV-së	Përgatit dhe paraqet në Këshillin Bashkiak Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
Dhjetor	Deri - 31 Dhjetor	Këshilli I Njësive Vendore	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
Janar	15	Kryetari I NJQV-së	Kryetari shpërndan kalendarin e programit buxhetor afatmesëm tek të gjitha njësitë shpenzuese
Janar	31	Kryetari I NJQV-së	Kryetari I njësive paraqet për shqyrtim dhe miraton raportin e vlerësimit të të ardhurave
Mars	1	Këshilli I Njësive Vendore	Miraton raportin e vlerësimit të të ardhurave
Mars	Brenda dates 15	Kryetari I NJQV-së	Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-së tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA
Mars	15	Këshilli I Njësive Vendore	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm
Mars	20	Kryetari I NJQV-së	Miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësive vendore dhe e shpërndan tek njësitë shpenzuese
Mars-Prill	21 Mars -25 Prill	Njësitë shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Mars-Prill	26 Prill -27 Prill	Njësia e vetëqeverisjes vendore	Zhvillojnë takime konsultive me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për PBA 2027-2029
Mars-Prill	28 Prill- 30 Prill	Njësitë shpenzuese të bashkisë	Njësitë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat e përgatitura
Maj	1 Maj - 15 Maj	Njësia përgjegjëse për Buxhetin	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	16 Maj - 26 Maj	Kryetari I NJQV-së	Organizon seancat dëgjimore me banorët
Maj	27 Maj - 29 Maj	Kryetari I NJQV-së	Prezanton dokumentin e PBA 2027-2029 me shoqërinë civile
Maj	30 Maj - 31 Maj	Njësia përgjegjëse për Buxhetin	Përpilon draftin e fazës parë të PBA 2027-2029
Qershor	1	Kryetari I NJQV-së	Dërgon pranë Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri - 20	Ministria e Financave	Dërgon komente një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri - 25	Njësia përgjegjëse për Buxhetin	Reflekton komentet e Ministrisë së Financave
Qershor	Deri -30	Këshilli I Njësive Vendore	Shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri -5 Korrik	Kryetari I NJQV-së	Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 20 Korrik	Këshilli I Njësive Vendore	Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	25	Kryetari I NJQV-së	Miraton udhëzimin plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe shpërndan tek njësitë shpenzuese
Korrik-Gusht	26 Korrik-31 Gusht	Njësitë shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara në përputhje me tavanet përfundimtare
Shtator	1	Njësitë shpenzuese të bashkisë	Njësitë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat buxhetore të rishikuara
Shtator	2 Shtator -14 Shtator	Njësia përgjegjëse për Buxhetin	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	Deri -15	Kryetari I NJQV-së	Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar
Shtator- Tetor	Deri - 5 Tetor	Ministria e Financave	Organizon seanca konsultimi me njësitë e vetqeverisjes vendore
Tetor	Deri - 20 Tetor	Ministria e Financave	Sipas rastit Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të PBA
Tetor-Nentor	6 Tetor -30 Nentor	Njësia përgjegjëse për Buxhetin	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2027 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2027-2029 DHE I PARAQET PËR SHQYRTIM NË KËSHILL.
Dhjetor	25	Këshilli I Njësive Vendore	Miraton programin buxhetor afatmesëm përfundimtarë dhe buxhetin vjetor.
Dhjetor	31	Kryetari I NJQV-së	Merr masat për publikimin e dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm.